



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2411 Prot.

Tiranë, më 15 /07 /2026

V E N D I M

Nr. 24, datë 10.07.2026

P Ë R

**NJË SHITESË TË VENDIMIT NR. 06, DATË 12.03.2026 “PËR KUOTAT E PRANIMIT
PËR PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË, PROGRAMET E
INTEGRUARA TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË DHE PROGRAMET E STUDIMIT
TË CIKLIT TË DYTË, PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027, NË UNIVERSITETIN
POLITEKNIK TË TIRANËS”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies, neni 18, pika 2, mbështetur në propozimet e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike dhe të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës për kuotat e pranimit për vitin akademik 2026-2027, Senati Akademik në mbledhjen e datës 10.07.2026,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kuotave të pranimit për programin e ri të ciklit të dytë të studimit “Master i Shkencave në Inxhinieri Kimike”, në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, të Universitetit Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2026-2027.
2. Miratimin e kuotave të pranimit për programin e ri të ciklit të dytë të studimit “Master i Shkencave në Arkitekturë Interieri dhe Dizajn”, në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, të Universitetit Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2026-2027.
3. Vendimit i bashkëngjiten tabelat e shpërndarjes së kuotave të pranimit sipas kategorive, për këto programe të reja studimi, për vitin akademik 2026-2027.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë,

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo

